



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c) dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen vokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 26.12.2018, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet plani punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2019 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2019.

Neni 2

Pjesë për bërse e këtij vendimi është plani punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2019 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2019.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”), nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhët KUÇI

01-Nr-016-81133
Me datë 26.12.2018.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY OF SUHAREKA SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-81133

Me datën 12.12.2018

Planifikimi i planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë për vitin 2019.

Janar	<ol style="list-style-type: none">1. Miratimi i Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës2. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës3. Informatë për aktivitetet e KKSb-së për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 20184. Miratimi i planit të transparencës për vitin 2019-20215. Raportimi për dhunën në familje6. Vendim për subvencionimin e grave që lindin fëmijët në QKMF në Suharekë.	Aktivitetet
Shkurt	<ol style="list-style-type: none">1. Bartja e mjeteve vetanake të vitit 2018 për shfrytëzim në vitin 20192. Miratimi i raportit të punës dhe aktiviteve të Komisionit Komunal të aksionarëve për NPL "Stacioni i Autobusëve" në Suharekë për vitin 20183. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës4. Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 20195. Raport pune për zyrën e prokurimit për vitin 2018	
Mars	<ol style="list-style-type: none">1. Caktimi i lokacioneve për vendosjen e trafostacioneve dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës publike2. Raporti përfundimtar financiar për vitin 20183. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës4. Themelimi i Komiteteve Konsultative5. Vendimi për kufizimin e numrit të ndarjes së Mirënjohjeve për "13 qershorin"	
Prill	<ol style="list-style-type: none">1. Informatë për raportin financiar 3 mujor e par të vitit 20192. Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal3. Miratimi i taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, lejes së rrënimit dhe tarifave për rritjen e densitetit në infrastrukturës4. Miratimi i planit të integritetit për periudhën 2019-20225. Raport për gjendjen e zonës industriale në Shirok	
Maj	<ol style="list-style-type: none">1. Vendimi për ndarjen e shpërblimeve për nder të "13 Qershorit" ditës së çlirimit të Suharekës2. Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës3. Shqyrtimi i raportit të performancës së Komunës për vitin 2018	
Qershor	<ol style="list-style-type: none">1. Korniza Afatmesme Buxhetore (2019-2021)2. Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 20183. Rishikimi i buxhetit për vitin 20194. Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës	

Korrik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konsultimi publik dhe pjesëmarrja e publikut ne vendim marrje 2. Informate e Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare për gjashte mujorin e pare të vitit 2018 3. Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2019 	
Gusht	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitit 2019 2. Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba komunale 3. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 	
Shtator	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Buxhetit dhe Plani i Investimeve për vitin 2020 2. Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme 3. Miratimi i emërtimit të zonave të qarkullimit publik në territorin e Komunës së Suharekës 4. Vendimi për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” 	
Tetor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informate për raportin financiar 9 mujor e vitit 2019 2. Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 3. Miratimi i raportit te komisionit për dhënien ne shfrytëzim afat gjatë pronës së paluajtshme te Komunës 4. 	
Nëntor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raport nga Drejtoria e pronës për qiranë dhe rentën 2. Miratimi i Rregullores për Transparencën 3. Miratimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në prona publike 	
Dhjetor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikim i punës së Kuvendit dhe orari i mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Suharekës, për vitin 2020 2. Miratimi i planit vjetor të punës të këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020 3. Raporti për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së 	

Përveç këtyre temave Kuvendi i Komunës së Suharekës, do të shqyrtoj dhe miraton edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI